

## Shtojca 13

### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

*Pogradec, më 08.04.2021*

Për: Operatorin Ekonomik, JOKLEN & CO SHPK, me numër NIPT: K84322601F, me adresë "Korce Velcan VELCAN Fshati Velçan, objekt privat 1- kat, afër zyrave të Njesisë Administrative, me nr pasurie 242/32, zona kadastrale 3728".

Procedura e prokurimit: Prokurim Elektronik" - "Kërkesë për Propozime" - "Shërbime".

Numri i referencës së procedurës: REF-89369-03-09-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Objekti "Hartimin plani, Mbarshtim dhe menaxhimi ekonomia pyjore Bishnice, pjesa ekonomike Talle dhe ekonomia kullusore "Guri Top Gjemth", me fond limit 5 075 663,5 (Pese milion e shtatedhete e pese mije e gjashteqind e gjashtedhete e tre presje pese) lekë dhe afat për realizimin e shërbimit: 6 (Gjashtë) muaj, duke filluar nga e nesërmja e datës së nënshkrimit të kontratës.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 38, datë 16 Mars 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Çmimi më i ulët

Oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

#### 1. LURIMI SHPK

**NIPT: J68403912U**

Vlera e ofertes pa TVSH: 4 030 490 (Kater milion e tridhete mije e katerqind e nentedhete) Lekë

#### 2. JOKLEN&CO SHPK

**NIPT: K84322601F**

Vlera e ofertes pa TVSH: 5 066 547,5 (Pese milion e gjashtedhete e gjashte mije e peseqind e dyzete e shtate presje pese) lekë.

### 3. LORENCO & CO SHPK

NIPT: J61903071B

Vlera e ofertes pa TVSH: 4 387 669,3 (Kater milion e treqind e tetedhete e shtate mije e gjashteqind e gjashtedhete e nente presje tre) lekë.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

#### 1. LURIMI SHPK

NIPT: J68403912U

#### 2. LORENCO & CO SHPK

NIPT: J61903071B

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

A. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik LORENCO & CO SHPK, NIPT: J61903071B, rezultoi se dokumentacioni i paraqitur ne S.P.E, NUK eshte ne perputhje me kriteret e vendosura ne DST, duke i parashtruar si me poshtë vijon:

1. O. E LORENCO & CO SHPK, nuk deshmon që plotëson kriterin 2.3.7 të DST konkretisht per arsyet si me poshtë:

- Së pari, Certifikata ISO 45001:2018 e dorezuar në S.P.E është e zbatueshme për vargjet e mëposhtme të produktit ose shërbimeve:

*Sistemet e informacionit gjeografik (GIS), fotogrametrisë, shërbime të planifikimit dhe hartografise; marketing, trajnim dhe asistencë teknike për pajisjet e lidhura me këtë sektor. Projektimi i infrastrukturës civile. Konsulencë inxhinierike dhe shërbime të mbikëqyrjes në fushën e infrastrukturës civile. Ekspertizë në vlerësimet mjedisore.*

**dhe jo sipas kërkeses se kriterit 2.3.7**, ku kerkohet qe: *Operatoret ekonomikë ofertues duhet te kete certifikata cilesie ne gjuhen shqipe, ose te perkthyer dhe te noterizuara per fushen e veprimtarive: "Shërbime profesionale për zbatime ne pyje dhe kullota" që perfshihen .....Shërbime profesionale për projekte: projekte komplekse të menaxhimit të pellgjeve ujëmbledhës, plane mbarëshkrimi të pyjeve, kullotave, florës dhe faunës.*

Së dyti: Certifikata ISO 45001:2018 e dorezuar në S.P.E, permban te dhenat si më poshtë:

Nr. Çertifikatës:	AL205018C-1
Data Regjistruese Fillestare	16 Shkurt 2018
Data e Çertifikatës	06 Shkurt 2020
Auditi Mbikqyrës në ose përpara	15 Shkurt 2021
Ri-çertifikimi detyrueshëm / <b>Skadimi i certifikatës</b>	<b>15 Shkurt 2021</b>

Per sa me siper, rezulton se certifikata ka skaduar më **15 Shkurt 2021, cka vjen ne kundërshtim me dispozitat e kriterit 2.3.7 të DST, ku kërkoheq që:** Çertifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

**2. Së pari, certifikata EN- ISO 9001-2015, e dorezuar në S.P.E është me fusheveprimi:**

*Sistemet e informacionit gjeografik (GIS), fotogrametrisë, shërbime të planifikimit dhe hartografise; marketing, trajnim dhe asistencë teknike për pajisjet e lidhura me këtë sektor. Projektimi i infrastrukturës civile. Konsulencë inxhinierike dhe shërbime të mbikëqyrjes në fushën e infrastrukturës civile. Ekspertizë në vlerësimet mjedisore.*

**dhe jo sipas kërkeses se kriterit 2.3.7, ku kërkoheq që:** *Operatoret ekonomikë ofertues duhet te kete certifikata cilesie ne gjuhen shqipe, ose te perkthyer dhe te noterizuara per fushen e veprimitarive: "Shërbime profesionale për zbatime ne pyje dhe kullota" që perfshihen .....Shërbime profesionale për projektme: projekte komplekse të menaxhimit të pellgjeve ujëmbledhës, plane mbarështimi të pyjeve, kullotave, florës dhe faunës.*

Së dyti: Nga verifikimi i kryer në adresa <https://kingcert.com/sertifika-sorgula/al/> , rezulton se kjo certifikate eshte me status, sipas fletes se printuar dhe e renditur si me poshtë:

---

**Statusi i Certifikatës**

Pezulluar ose i Anuluar

Per sa me siper, rezulton se certifikata eshte e pezulluar ose e anuluar, **cka vjen ne kundërshtim me dispozitat e kriterit 2.3.7 të DST, ku kërkoheq që:** Çertifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

**3. Me dokumentacionin e dorezuar ne S.P.E, O. E LORENCO & CO SHPK, nuk deshmon që ka realizuar shërbime te ngjashme, konkretisht per arsyet si me poshtë:**

Së pari: Ne praktika e shërbimit/punes se ngjashme, Kontrata me objekt "Hartim plani per mbarështimin e ekonomive pyjore Kostenje", mungon formular vlerësimi nga investitori sipas shtojcës përkatëse, vlerësuar me notë ose me fjalë.

Per arsye se dokumentacioni i paraqitur nuk eshte ne perputhje me kriterin 2.3.1 të DST, perben arsye per skualifikim.

Së dyti: Ne praktika e shërbimit/punes se ngjashme, Kontrata me objekt "Hartim i planit të mbarshtimit të fondit pyjor dhe kullësor, pjesë të ekonomisë pyjore Orgockë për vitin 2020, Bashkia Kolonjë", vlera e kontratës 888 936 leke pa TVSH, nuk përmbush kriterin 2.3.1 të DST, pasi nuk është me i madh se 40 % e fondit limit.

Së treti: Kontrata me objekt "Studim fushor për mbledhjen e të dhënave, krijimi i databazë dhe dixhitalizimi për 5750 njësi ulliri", nuk konsiderohet si shërbim i ngjashëm, pasi nuk ka ngjashmëri në zerat e preventivit të prokuruar si dhe mungon formular vlerësimi nga investitori sipas shtojcës përkatëse, vlerësuar me notë ose me fjalë.

**4.** Me dokumentacionin e dorëzuar në S.P.E, O. E LORENCO & CO SHPK, nuk dëshmon se përmbush kriterin 2.3.2 të DST, konkretisht për arsyt si më poshtë:

Së pari: Licenca me Kod IV.4.A e ngarkuar në S.P.E, është me emëtimin përshkrues të veprimtarisë "Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet minerare (Kat. 9 a,b, c, d, e)" dhe JO sic kërkohe në Dokumentat e Tenderit me veprimtarinë "Shërbime ekspertize për veprimtarinë studiuese-projektuese dhe zbatuese në veprimtarinë e kërkim-zbulimit, shfrytëzimit dhe përpunimit të mineraleve".

Së dyti: Licenca me Kod III.7.A e ngarkuar në S.P.E, është me emëtimin përshkrues të veprimtarisë "Shërbime profesionale për projektme. Shërbime profesionale për zbatime" dhe JO sic kërkohe në Dokumentat e Tenderit me veprimtarinë "Shërbime profesionale për projektme, Shërbime profesionale për zbatime, Shërbime të ekspertizës dhe çertifikimit. Shërbime profesionale për studime e aplikime profesionale në pyje dhe kullota".

Te gjitha mangësitë e konsistuar me sipër, për sa kohë që vijne në kundërshtim me kriteret e DST, përbejnë arsye për skualifikim.

Për sa me sipër, Komisioni i vlerësimit të ofertave mbështetur në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;" si dhe në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit,

## VENDOSI:

Të S'kualifikojë ofertën e e paraqitur nga Operatori Ekonomik LORENCO & CO SHPK, NIPT: J61903071B, me ofertën e paraqitur në vlerën 4387669,3 Lekë pa TVSH.

\*\*\*\*\*

**B.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik LURIMI SHPK, NIPT: J68403912U, rezultoi se dokumentacioni i paraqitur në S.P.E, NUK është në përputhje me kriteret e vendosura në DST, duke i parashtruar si më poshtë vijon:

**1.** Shtojca 1/1, NUK është plotësuar në mënyrën e sakte, pasi NUK është përzgjedhur asnjë nga opsionet 6/a ose 6/b,

**2.** Shojca 4, nuk është plotësuar me të dhënat e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

**3.** O. E LURIMI SHPK, nuk dëshmon që ka realizuar shërbime të ngjashme, sipas kërksave të kriterit 2.3.1 të DST, konkretisht për arsye si më poshtë:

- Në pari, kontrata e dorëzuar në S.P.E nuk rezultoi e përfunduar dhe marrë në dorëzim, pasi sipas vërtetimit të vlerësimit, procesi i shërbimit është realizuar deri në 70 %.

- Në dyti, mungon situacioni/et pjesore ose situacioni përfundimtar, të shoqëruar me faturën përkatëse.

- Në treti, nga dokumentacioni i dorëzuar në S.P.E, nuk dëshmohej që edhe 70 % i shërbimit të realizuar, të jetë marrë në dorëzim nga "Supervizori/mbikqyresit i shërbimit", "Komisioni i Monitorimit nga A.K" dhe "Certifikuesi i projektit", detyrime këto që rrjedhin nga V.K.M -ja Nr.361, datë 12.5.2010, "Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullësor publik".

Të gjitha mangësitë që parashtruar më lart, vijnë në kundërshtim me kriterin 2.3.1 të DST dhe nenin 28 të V.K.M -se 914, dhe përbejnë arsye për skualifikim.

**4.** Nga ballafaqimi i kryer me dokumentat e ngarkuar në S.P.E, O.E nuk ka ngarkuar dokumentat:

- License Kodi IV.4.A Shërbime ekspertize për veprimtarinë studiuese-projektuese dhe zbatuese në veprimtarinë e kërkim-zbulimit, shfrytëzimit dhe përpunimit të mineraleve.

- License Kodi III.2.A Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (ndikim në mjedis dhe auditim mjedisor).

Gjithashtu, nga verifikimi i kryer ne adresa <https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/> , rezulton se O.E LURIMI SHPK, disponon vetem licencat e meposhtme:

- Leje mjedisore e tipit C për shfrytëzim dhe përpunim të lëndës drusore, Kodi Kodi: III.1.A ().
- Licence, Prodhimi dhe tregtimi i farave dhe fidanëve, Kodi: II.4 ().
  
- Leje, Proçedurë paraprake e vlerësimit të ndikimit në mjedis për aktivitetin: Pyllëzime me fidanë pyjorë, dekorative dhe fidanishte pyjore, Kodi: III.1.C ().
  
- Licence, A-Shërbime të ekspertizës dhe çertifikimit. BShërbime profesionale për studime e aplikime profesionale në pyje dhe kullota. C-Shërbime profesionale për projektme D-Shërbime profesionale për zbatime, Kodi: III.7.A ().

Per sa me siper, O.E pjesemarres LURIMI SHPK, nuk deshmon me dokumentacion qe permbush kriteret 2.3.2.2 dhe 2.3.2.3 te DST.

**5. Nga verifikimi i kryer ne S.P.E rezulton se O.E nuk ka ngarkuar dokumenta qe te deshmoje një punësim mesatar i të paktën 8 (Tete) personave, për periudhën Shtator 2020 – Janar 2021, të vërtetuar me;**

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj per periudhen **Shtator 2020 – Janar 2021.**
  
- List pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Shtator 2020 – Janar 2021.**

Nga verifikimi i kryer ne S.P.E rezulton se O.E ka dorezuar vetem listepagesen e muajit shkurt 2021.

**6. Per shkak se mungojne listepagesat per periudhen Shtator 2020 – Janar 2021, O.E pjesemarres nuk deshmon qenien ne listpasese Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, per periudhen Shtator 2020 – Janar 2021.**

**7. Per shkak se mungojne listepagesat per periudhen Shtator 2020 – Janar 2021, O.E pjesemarres nuk deshmon qenien ne listpasese nje topograf ose teknik topograf, Shtator 2020 – Janar 2021.**

Per sa me siper, Komisioni i vleresimit te ofertave mbeshtetur në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të

kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përkrahur nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;” si dhe në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit,

#### VENDOSI:

Të S'kualifikojë ofertën e e paraqitur nga Operatori Ekonomik LURIMI SHPK, NIPT: J68403912U, me oferten e paraqitur në vlerën 4030490 Lekë pa TVSH.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik, JOKLEN & CO SHPK, me numër NIPT: K84322601F, me adresë "Korce Velcan VELCAN Fshati Velcan,objekt privat 1- kat,afër zyrave të Njesisë Administrative, me nr pasurie 242/32, zona kadastrale 3728", se oferta e paraqitur, me një vlerë pa TVSH prej 5 066 547,5 (Pese milion e gjashtedhjetë e gjashtë mijë e peseqind e dyzete e shtate presje pese) lekë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ndermarrjes së Mirembajtjes së Infrastrukturave dhe Puneve Publike, Bashkia Pogradec, Kati II, Ish zyrat e Arkivit të Shtetit, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (Pesë) ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi në buletin e APP-së.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, procedura e prokurimit do të anulohet siç parashikohet në Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 31.03.2021.

Ankesa: JO

**[TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR]**  
**ENTON BERBERI**